

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Austria ndalon shaminë për vajzat nën 14 vjeç, shpërthen debati për lirinë fetare
ADRESA	https://tpz.al/austria-ndalon-shamine-per-vajzat-nen-14-vjec-shperthen-debati-per-lirine-fetare-i332838
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 18:52:19 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 16:54:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	07b9550587f13a200474cbe4fc511bfe15c6818f8e47c5e819e07291c0efd428
TEKSTI	428740a781f97bd3ee760a25d03704502738b225a81d964167e8e82f16359dfa
PAMJA	6c3ffe228841247721765f983423ab70f946f0fee105bb03fff5906c4122cf51

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9c4f3312d2536c52b6b55ee6486fa337910437b3c16fd9176aff4effd744288f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9c4f3312d2536c52b6b55ee6486fa337910437b3c16fd9176aff4effd744288f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

18:08 PDK e konsideron Kuvendin të pakonstituuar dhe Qeverinë jokushtetuese: Do t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese • 15:54 Zgjidhet qeveria e re e Kosovës, Albin Kurti p

BOTA, 13 SEPTEMBER 2026, 18:54

Austria ndalon shaminë për vajzat nën 14 vjeç, shpërthen debati për lirinë fetare

tpz.al TPZ



Një ndalim i ri për mbajtjen e shamisë islame në shkollat austriake ka rikthyer në qendër të vëmendjes debatin mbi lirinë fetare, të drejtat e fëmijëve dhe presionin familjar.

Që nga fillimi i vitit të ri shkollor, më 1 shtator, vajzat nën moshën 14 vjeç në Austri nuk lejohen të mbajnë në shkollë shami që "mbulon kokën në përputhje me traditat islame".

Përfaqësuesit e mësuesve thonë se rregulli i ri është zbatuar përgjithësisht në mënyrë të qetë dhe me respekt. Megjithatë, disa shkolla kanë raportuar konflikte dhe, në raste të caktuara, edhe reagime agresive.

Ndalimi ishte i debatueshëm që përpara se të hynte në fuqi, pasi kritikët ngritën pikëpyetje mbi përputhshmërinë e tij me lirinë e fesë dhe parimin e barazisë, transmeton Telegrafi.

Në vitin 2020, Gjykata Kushtetuese e Austrisë e rrëzoi një ndalim të mëparshëm të shamisë. Ligji i atëhershëm ndalonte nxënëset e shkollave fillore të mbanin veshje fetare ose ideologjike që mbulonin kokën, deri në përfundim të vitit shkollor kur ato mbushnin 10 vjeç.

Gjykata arriti në përfundimin se rregullorja cenonte parimin e barazisë dhe lirinë fetare, duke argumentuar se në praktikë ajo synonte kryesisht shaminë "islame".

Ligji i ri ndryshon kryesisht përmes rritjes së kufirit të moshës, duke e shtrirë ndalimin deri në moshën 14 vjeç.

Qeveria austriake argumenton se qëllimi kryesor është mbrojtja e zhvillimit të fëmijëve dhe e lirisë së tyre për të formuar personalitetin, duke pretenduar se vajzat duhet të mbrohen nga presioni i mundshëm familjar apo shoqëror për të mbajtur shami.

Megjithatë, Gjykata Kushtetuese ende nuk ka vendosur nëse ky arsyetim i ri dhe mënyra se si është hartuar ndalimi i përgjigjen shqetësimeve kushtetuese të ngritura më parë.

Për momentin, zbatimi i ligjit u është besuar shkollave dhe mësuesve. Nëse një mësues konstaton se një nxënëse po mban shaminë e ndaluar, hapi i parë është t'i kërkojë asaj ta heqë.

ide!

John Goci konkurron Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?

Nga Thoma Gëllçi

"Liria punon", por duhen edhe 6 milionë dollarë!

Nga Mero Baze

Tej e Këtej



Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori? Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

[Shiko të tjera video](#)

Nëse nxënësja refuzon, zhvillohen diskutime të mëtejshme dhe, nëse është e nevojshme, përfshihet autoriteti arsimor.

Vetëm në fazat e mëvonshme mund të nisë procedura për vendosjen e sanksioneve administrative.

Në rast të shkeljeve të përsëritura, procesi mund të kalojë në disa etapa, ndërsa prindërit ose kujdestarët ligjorë mund të përballen me gjoba nga 150 deri në 800 euro, nëse shamia vazhdon të mbahet pavarësisht kërkesës për ta hequr.

Përfaqësuesit e sindikatës së mësuesve kanë kritikuar detyrimin për të raportuar shkeljet, duke paralajmëruar se kjo mund t'i vendosë mësuesit në një rol mbikëqyrës që shkon përtej detyrës së tyre arsimore.

Debati është zgjeruar edhe te rastet e mundshme të kërcënimeve dhe refuzimit të vajzave për të ndjekur mësimin.

Qeveria austriake kishte paralajmëruar edhe para miratimit të ligjit për raste në të cilat vajzat apo gratë mund të jenë përballur me presion për të mbajtur ose hequr shaminë.

Ministrja e Integritetit, Claudia Plakolm, ka përmendur edhe raste kërcënimesh brenda familjeve.

Megjithatë, aktualisht nuk ekzistojnë statistika që të tregojnë se sa të shpeshta janë situata të tilla në shkollat austriake.

Edhe raportimet për nxënëse që nuk ndjekin fare mësimin, ose e ndjekin atë në mënyrë të parregullt për shkak të ndalimit, ende duhet të vlerësohen në mënyrë të plotë. Deri tani flitet për raste të izoluara të refuzimit dhe konflikteve.

Mbështetësit e ligjit argumentojnë se vajzat e kësaj moshe janë veçanërisht të varura nga familjet e tyre dhe për këtë arsye mund të jenë të ekspozuara ndaj presionit të konsiderueshëm social ose fetar.

Kritikët, nga ana tjetër, pyesin nëse një ndalim shtetëror mund ta forcojë realisht vetëvendosjen e vajzave. Sipas tyre, një vajzë që dëshiron të mbajë shami "me bindjen e saj" nuk mund ta zbatojë më këtë zgjedhje në shkollë për shkak të ndalimit.

Psikologja Christiane Spiel ka paralajmëruar gjithashtu për konflikte të mundshme besnikërie te fëmijët. Në një deklaratë për ORF, ajo vuri në dukje se një situatë ku prindërit kërkojnë mbajtjen e shamisë, ndërsa shkolla kërkon heqjen e saj, mund të krijojë një konflikt të fortë për fëmijën.

Përpara hyrjes në fuqi të ligjit, disa prindër tentuan ta kundërshtonin drejtpërdrejt atë në Gjykatën Kushtetuese.

Gjykata i hodhi poshtë kërkesat për arsye procedurale, pasi personat në fjalë ende nuk ishin prekur drejtpërdrejt nga ligji në atë moment.

Tashmë është paraqitur një kërkesë e re për rrëzimin e ligjit. Çështja kryesore pritet të jetë sërish raporti mes lirisë fetare dhe parimit të barazisë.

Gjykata do të duhet të shqyrtojë nëse mbrojtja e fëmijëve nga presioni fetar apo familjar mund të justifikojë një "ndërrhyrje në lirinë e fesë", si dhe nëse ndalimi i përgjithshëm i shamisë është i nevojshëm dhe proporcional për arritjen e këtij qëllimi.

Kështu, vendimi i ardhshëm i Gjykatës Kushtetuese mund të përcaktojë jo vetëm fatin e ligjit të ri, por edhe mënyrën se si Austria do të balancojë mbrojtjen e fëmijëve me të drejtën për lirinë e besimit.

BOTA / 13 September 2026, 18:53

Trump akuzon Zelenskyn për sulmet ndaj depove ruse të karburantit: Po e dëmton botën, ndiq qëllimet e tua, jo naftën

BOTA / 13 September 2026, 18:06

27-vjeçarja hidhet nga kati i 15-të i pallatit, bie sipër karrocës me fëmijë

BOTA / 13 September 2026, 15:56

Kremlini: Bisedimet trepalëshe SHBA-Rusi-Ukrainë mund të zhvillohen në tetor

BOTA / 13 September 2026, 14:58

Turqia nis operacion kundër organizatave LGBTQ+, arreston dhjetëra persona

BOTA / 13 September 2026, 13:42

Trump zhgënjën Arabinë Saudite, Princi Bin Salman i telefonoi dy herë, por SHBA refuzoi të qëllonte rebelët Houthi

BOTA / 13 September 2026, 13:41

Tri humbje dhe më afër fitores se kurrë, 2027-a mund të jetë viti i Marine Le Pen

BOTA / 13 September 2026, 13:39

Goditet një pikë karburanti pranë kufirit me Poloninë, ministri ukrainas: Terrori i Putinit po troket në dyert e BE dhe NATO-s

BOTA / 13 September 2026, 12:43

A mund t'i mbijetojë tregu i naftës një lufte të përjetshme me Iranin?

BOTA / 13 September 2026, 11:00

Një 21-vjeçar nga India hoqi mbeturinat nga lumi, merr ofertë pune nga Holanda

BOTA / 13 September 2026, 10:30

"Nëse do bisedime eja në Moskë", Lavrov i përgjigjet Zelenskyt: Nuk na mungon vullneti, por atij i mungon karakteri

BOTA / 13 September 2026, 10:29

"IA mund të bëhet e rrezikshme nëse nuk menaxhohet siç duhet", Obama ngre alarmin: S'duhet të kontrollohet nga duar private

BOTA / 12 September 2026, 20:58

Kina kërcënon me anulimin e samitit Xi-Trump nëse SHBA miraton shitje të reja armësh për Tajvanin

BOTA / 12 September 2026, 20:47

Mbijetoi tri ditë mbi varkën e përmbysur në Detin Bering, 15-vjeçari shpëtohet pasi humbi vëllain dhe kushëririn

BOTA / 12 September 2026, 20:29

Gjermania në protesta kundër AfD-së, rreth 150 mijë njerëz në rrugë pas fitores së ekstremit të djathtë

BOTA / 12 September 2026, 20:11

Samiti i BRICS-it, mesazh për Lindjen e Mesme: Dialog dhe paqe

BOTA / 12 September 2026, 19:42

Kremlini i përgjigjet Zelenski-t: Nëse do takim me Putinin mund të vish në Moskë

BOTA / 12 September 2025, 18:38

**"Jam gati të takohem me
Putin në Samitin e G20 në
SHBA" - Zelensky: Duhet të**

BOTA / 12 September 2025, 17:38

**Trafik droge përmes pakove
postare, goditet banda
kriminale në Valencia/**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.